

URDHËR
Nr. 171, datë 19.3.2026

**PËR AUTORIZIMIN DHE DELEGIMIN E DISA KOMPETENCAVE/
AUTORITETIT TË MINISTRIT TË DREJTËSISË, DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM
TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË MONITORIMIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; si dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Për plotësimin e detyrave funksionale, z. Geron Ibrahim, drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Monitorimit, i delegohen kompetencat dhe autoriteti i titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, si më poshtë:

a) Kompetencat e titullarit të ministrit të Drejtësisë për nënshkrimin e shkresave për mbajtjen e korrespondencave për kërkesat për zbatimin e ligjshmërisë dhe trajtimin e ankesave të institucioneve shtetërore, bizneseve dhe qytetarëve mbi zbatimin e ligjshmërisë në fushën e drejtësisë nga institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë në fushën penale dhe civile;

b) Kompetencat e titullarit të ministrit të Drejtësisë për nënshkrimin e shkresave, për mbajtjen e korrespondencave të ndryshme dhe kthimin e përgjigjeve për ankesa dhe kërkesa nga persona juridikë, fizikë, publikë dhe privatë, në lidhje me zbatimin e ligjit nga personat që ushtrojnë profesionet e lira nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Drejtësisë, me përjashtim të atyre për të cilat legjislacioni në fuqi ka parashikuar shprehimisht nënshkrimin nga ana e ministrit të Drejtësisë;

c) Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për nënshkrimin e regjistrit noterial.

2. Ushtrimi i kompetencave të deleguara sipas pikës 1 të këtij urdhri fillon nga data e hyrjes në fuqi e tij dhe përfundon me shfuqizimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Monitorimit, z. Geron Ibrahim, për zbatimin këtij urdhri.

4. Ngarkohet Sektori i Arkiv-protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Toni Gogu